



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 120-2316 /2026

Klinë, datë 11/01/2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, me rastin e deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e Drejtoreshës së Drejtorisë së Bujqësisë sipas shkresës së datës 19.01.2026, Kryetari i Komunës së Klinës, merr këtë;

V E N D I M

1. **AUTORIZOHET**, BINAK SYLAJ i emëruar Drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Klinës, që të kryej të gjitha veprimet e nevojshme procedurale lidhur me nënshkrimin e pagesave për ekspertin e veterinarisë Anton Marku.
2. Meqenëse drejtoresha e DBZHR ka paraqitur kërkesë për zëvendësim në lidhje me nënshkrimin e pagesave dhe procedurave tjera për zyrtarin e përmendur me arsyetimin e konfliktit të mundshëm të interesit, i autorizuari caktohet përgjegjës për kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale.
3. I autorizuari është përgjegjës të veproj në përputhje me autorizimet ligjore pozitive.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Binak Sylaj;
- DBZHR
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

